

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Paraburgimi"/ Gogu: Rishikim i Kodit të Procedurës Penale për masat e sigurimit, rekomandimet e Këshillit të Evropës po kthehen në reformë
ADRESA	https://tpz.al/paraburgimi-gogu-rishikim-i-kodit-te-procedures-penale-per-masat-e-sigurimit-rekomandimet-e-keshillit-te-evropes-po-kthehen-ne-reforme-i333232
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 09:08:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 09:02:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	02e3c77c3ef606796f63664cae5c15c186bb1a6542b463acc5c415a6c7a21237
TEKSTI	a7c4860768a0935d1f13b4c30a9b364e83b3a6349c4eda4708f6b9bf61befead
PAMJA	adac6884ace5087097155f788ee78faad2a48e5bfddc468b9bd61f2f06cf970b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6a899d57cf53e70bb7999b812db45266b1ade774f1c2b2c11045db08fbab977e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	219f872b2d436154cbce21b1357d2a6f04cc2d43ba2a7914d91c1ebdf0665477
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6a899d57cf53e70bb7999b812db45266b1ade774f1c2b2c11045db08fbab977e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

11:02 "Paraburgimi"/ Gogu: Rishikim i Kodit të Procedurës Penale për masat e sigurimit, rekomandimet e Këshillit të Evropës po kthehen në reformë • 10:56 Kuvendi/ Replik

AKTUALITET, 18 SEPTEMBER 2026, 11:02

"Paraburgimi"/ Gogu: Rishikim i Kodit të Procedurës Penale për masat e sigurimit, rekomandimet e Këshillit të Evropës po kthehen në reformë

tpz.al TPZ



Ministri i Drejtësisë, Toni Gogu, bëri të ditur sot se rekomandimet e Këshillit të Evropës për paraburgimin po ushqejnë drejtpërdrejt punën e nisur për rishikimin e Kodit të Procedurës Penale, me fokus forcimin e garancive për lirinë e personit dhe funksionimin real të alternativave ndaj arrestit në burg.

Duke folur në tryezën kushtuar masave të sigurimit, vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gogu theksoi se puna me Këshillin e Evropës po kalon nga rekomandimet te procesi i reformës.

"Puna jonë me Këshillin e Evropës nuk mbaron me dokumentin që diskutojmë sot.

ide!

Vendimi i Hagës si moment reflektimi
Nga Ergys Mërtiri

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Rekomandimet e tij po ushqejnë drejtpërdrejt punën që kemi nisur për rishikimin e Kodit të Procedurës Penale", deklaroi ministri.

[Shiko të tjera video](#)

Sipas Gogut, në këtë proces po shqyrtohen çështje që lidhen me kriteret për paraburgimin, arsyetimin e individualizuar të masës, shqyrtimin real të masave më pak kufizuese, aksesin në materialet mbi të cilat mbështetet kërkesa për masë sigurimi dhe forcimin e alternativave.

Ministri theksoi se drejtimi i reformës duhet të ruajë njëkohësisht efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale dhe garancitë e procesit të rregullt e të lirisë së personit.

"Kapaciteti i shtetit për të hetuar dhe ndjekur penalisht duhet të mbetet i fortë. Por po aq të forta duhet të jenë garancitë e procesit të rregullt dhe mbrojtja e lirisë së personit. Njëra nuk fitohet duke dobësuar tjetrën", tha Gogu.

Krahas ndryshimeve ligjore, Ministria e Drejtësisë po punon për rikthimin në funksion të mbikëqyrjes elektronike, si një nga instrumentet që u jep gjykatave mundësi reale për zbatimin e masave alternative.

Gogu tha se është siguruar financimi i nevojshëm për vitin 2027 dhe se objektivi është që sistemi i mbikëqyrjes elektronike të jetë operacional në mars 2027.

"Një alternativë që shteti nuk e ofron realisht, nuk është alternativë. Kjo është përgjegjësi e ekzekutivit, jo e gjykatës", deklaroi ministri.

Sistemi parashikohet të mbështetet me personel të trajnuar, protokolle të qarta reagimi dhe raportimi ndaj gjykatës dhe prokurorisë, si dhe me forcimin e kapaciteteve të Shërbimit të Provës.

Ministri nënvizoi gjithashtu kufirin institucional mes ekzekutivit dhe gjyqësorit, duke theksuar se Ministria e Drejtësisë nuk ka rol në vendimin se çfarë mase sigurimi duhet të caktohet në një çështje konkrete.

"Gjykata e Lartë ka qartësuar standardin. Ne po punojmë që edhe kuadri ligjor ta mbështesë atë dhe po ndërtojmë mbikëqyrjen elektronike e po forcojmë Shërbimin e Provës që alternativat të jenë reale dhe të besueshme.

Ligj më i qartë. Alternativa reale. Institucione që funksionojnë.

Kjo është pjesa që na takon ne", përfundoi Gogu.

AKTUALITET / 18 September 2026, 10:56

Kuvendi/ Replikat mes Bardhit e Zegjinesë: A t'u martua daja? Deputetja e PS: Ti duhet të shohësh hallin tënd Gazo, a u martove vetë apo jo?

AKTUALITET / 18 September 2026, 10:43

Zhbllokimi/ Ligji u votua në orët e para të mëngjesit, presidenti Begaj dekreton pagat e reja të magistratëve

AKTUALITET / 18 September 2026, 10:34

E rëndë/ Shoferi humb kontrollin nga përgjumja, shkakton aksident në aksin Elbasan-Peqin, plagosen gruaaja dhe një fëmijë

AKTUALITET / 18 September 2026, 10:27

Kritika të forta ndaj kryeministrit të Kosovës, Ali Ahmeti: Jam i indinjuar me Albin Kurtin, t'i lërë pas zënkat me mua dhe Ramën!

AKTUALITET / 18 September 2026, 10:19

Ministrja Spahiu mbledh drejtuesit e 28 institucioneve të përkujdesit social: Përmirësim i shërbimeve, fokusi te grupet në nevojë

AKTUALITET / 18 September 2026, 10:04

Bojkoti/ Plagosja e avokatit Shllaku, Dhoma e Avokatisë Durrës pezullon seancat për 2 orë: Të bëhet hetim i plotë, kërkojmë siguri!

AKTUALITET / 18 September 2026, 09:58

Vendimi/ U ndaluan gjatë tensioneve në protestën te Parlamenti, lirohen 25 qytetarët, procedohen në gjendje të lirë

AKTUALITET / 18 September 2026, 09:52

Para nisjes në SHBA, Rama mbledh ministrat dhe drejtuesit politikë te "Vila e Kuqe"! Porositë që priten gjatë mungesës gati 1-javore

AKTUALITET / 18 September 2026, 09:45

Lokale me baste sportive afër shkollave në Tiranë, 2 të arrestuar dhe 2 të proceduar, mes tyre edhe të mitur!

AKTUALITET / 18 September 2026, 09:40

Ish deputeti i PD: Sot thoni dokrra në Kuvend, mbështetët krijimin e Gjykatës Speciale! Berisha votoi pro ngritjes së komisionit të Dick Marty

AKTUALITET / 18 September 2026, 09:33

VIDEO/ E kishin kthyer lokaln në 'fole' droge dhe bastesh në Koplik, arrestohet punonjësi, në kërkim administratori

AKTUALITET / 18 September 2026, 09:26

Hetimi/ Bllokimi i pagave të magjistratëve, SPAK merr në pyetje drejtoreshën e Thesarit, Elmira Peto

AKTUALITET / 18 September 2026, 09:22

"Nuk keni lënë plehrë pa e kthyer në hero" / "Becchetti", Rama në Kuvend: Ka ikur koha kur lloj-lloj legenësh e kriminelësh mund të merrnin çfarë të donin. Do të marrë zero lekë

AKTUALITET / 18 September 2026, 09:15

Detaje/ Plagosja e dy vëllezërve në Sarandë, vëllai i njërit prej të arrestuarve u përfshi në një sherr para tre javësh!

AKTUALITET / 18 September 2026, 09:07

Kuvend/ Pagat e magjistratëve, PS miraton rritjen sa 2% e pagës së Presidentit! Rama: Ligj i ri, jemi në konsultime me KiE! PD voton kundër: Puç kushtetues

AKTUALITET / 17 September 2026, 22:43

"Një puç kushtetues" / Bardhi për pagat e magjistratëve: Po sfidoni Kushtetutën, vota jonë do të jetë kundër

AKTUALITET / 17 September 2026, 22:18

'Ju pres në zvrë!' Shehai

AKTUALITET / 17 September 2026, 22:10

Rama shkon në Kuvend. pritet

reagon për videon e ministres:
Të sëmurët nuk duan t'ju
takojnë ju, duan që të mos i
vidhni ilaçet

të votohet drafti për pagat e
gjyqtarëve

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.